

**Nga: Instituti për Studime të Avancuara GAP**

**Për: Komisionin Parlamentar për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike,  
Qeverisje Lokale dhe Media**

**Subjekti: Amendamenti i Ligjit për Transmetimin Publik**

Për Institutin GAP, Ligji për Transmetimin Publik është një ligj vital për shoqërinë kosovare i cili do të duhej të garantonte pavarësinë institucionale dhe editoriale të transmetuesit publik në vend.

Për të kontribuar në këtë proces, Instituti GAP ka publikuar edhe një analizë të titulluar **‘Qëndrueshmëria financiare e RTK-së: gjetja e alternativave për financim të transmetuesve publik’**, ku mes tjerash ofrohet një pasqyrë financiare e RTK-së që nga themelimi i këtij mediumi dhe ofrohen ide rreth sigurimit të një qëndrueshmërie afatgjate financiare.

Në tryezën që GAP ka organizuar për prezantimin e kësaj analize, është parë nevoja që komisioni parlamentar të përfshij në diskutime edhe organizata tjera të shoqërisë civile. Madje një numër i konsiderueshëm i organizatave jo qeveritare, duke përfshi edhe GAP, kanë shpreh dëshirën që të jenë pjesë e punëtorisë për amendamentimin e ligjit e cila është mbajtur muajin e kaluar në Prevallë. Kërkesa e GAP dhe disa organizatave tjera është refuzu, pa ndonjë shpjegim të arsyeshëm. Andaj, GAP ka qenë një ndër organizatat që ka kërkuar nga komisioni parlamentar që amendamenti i Projektligjit për Transmetuesin Publik të bëhet në një proces transparent dhe më përfshirje më të gjerë të publikut.

Projektligji për transmetimin publik është shtyrë në agjendën legjislativë për dy arsye: 1. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për mënyrën e financimit dhe 2. Kritikata e Komisionit Evropian për qëndrueshmërinë financiarë të RTK. Të dy këto arsye ndërliidhen me mënyrën e financimit.

Por, projektligji të cilin komisioni parlamentar e ka në shqyrtim nuk zgjidh problemin e financimit të RTK, por e shtyn atë edhe për tri vite. Kjo nënkupton se edhe për tri vite në vazhdim, Kosova do të kritikohet nga raportet e progresit në këtë pikë.

Kur dihet se RTK që nga 1 dhjetori 2009 financohet nga buxheti i shtetit, dhe nëse kësaj i shtohen edhe tre vjet të tjera, përfundimisht RTK do të kishte një periudhë prej më shumë se pesë vjeçare të financimit direkt nga shteti. Financimi direkt nga shteti veç ka vënë në mëdyshje pavarësinë institucionale dhe editoriale të RTK-së nga ana e qytetarëve. Kështu që, nëse ky financim vazhdon edhe për tre vitet e ardhshme, mund të rezultojë me humbjen e më tejme të kredibilitetit të RTK-së. Kjo do ta bënte edhe më të vështirë bindjen e qytetarëve për parapagimin e RTK-së, që shihet si burim kryesor i financimit afatgjatë sipas këtij Ligji.

Andaj, një ligj i ri për transmetimin publik, nuk duhet fare të parasheh formë të financimit nga buxheti i shtetit.

Neni 23.3 i Projektligjit aktual duhet të riformulohet dhe të parasheh financim të RTK vetëm nga parapagimi duke filluar nga 1 janari 2012. Ose në rastin më ekstrem, Ligji i ri për RTK, duhet ti jap kohë Kuvendit dhe Bordit të RTK prej më së shumti 3-6 muaj me qëllim që Bordi të arrij një zgjidhje alternative për financim. Disa nga alternativat e mundshme të financimit ne i kemi përshkruar në analizën e GAP.

Pika e dytë që do të dëshiroja të diskutoja sot është **neni 28** që ka të bëjë me zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK. **Në pikën 2.2 të këtij neni, thuhet se anëtarët e bordit të RTK do të përzgjidhen nga një komision ad-hoc parlamentar.** Projektligji nuk e shtjellon më tutje përbërjen e komisionit ad-hoc, mirëpo për përbërjen e komisioneve ad-hoc bëhet fjalë në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës, respektivisht në nenin 71 të saj. Sipas Rregullores së Punës së Kuvendit, komisionet ad-hoc duhet të reflektojnë proporcionin e forcave parlamentare në Kuvend. Edhe pse një përbërje e tillë e komisionit është e drejtë në rastet e përzgjedhjes së bordve të ndërmarrjeve apo agjencioneve tjera, anëtarësia e komisionit ad-hoc që përzgjedh anëtarët e Bordit të RTK nuk duhet të reflektoj përbërjen parlamentare, që nënkupton se shumicën e votave do të kenë partitë në pushtet, por duhet të reflektoj një përbërje të barabartë partiake parlamentare. Kjo do të garantonte një përzgjedhje më të drejtë për anëtarësinë e bordit të RTK.

Për fund, jemi të informuar se Komisioni Parlamentar për Media ka themeluar një nënkomision apo grup punues për amendamentimin e Projektligjit për transmetuesin publik dhe atë për KPM. Andaj, GAP përmes me këtë letër njëkohësisht kërkon që të na lejohet pjesëmarrja në grupin punues për amendamentimin e këtyre projektligjeve, natyrisht pa të drejtë vote, ashtu siç e parashohin procedurat e Kuvendit të Kosovës.

Agron Demi  
Instituti për studime të Avancuara GAP

Prishtinë, 4 nëntor 2011